



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
PREFEKTI

Nr. 430 Prot.

Fier, më 08.04.2025

URDHËR

Nr. 27 datë 08.04.2025

PËR
PUBLIKIMIN E LISTËS SË DOKUMENTEVE EKZISTUESE QË OFROHEN
NË FORMATIN E TË DHËNAVE TË HAPURA

Në zbatim të nenit 8, shkronja "j", nenit 20, pika 1, të ligjit Nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut" (i ndryshuar), të nenit 7, pika 3, të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025, "Për detyrat e administratës së prefektit të qarkut" si dhe Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut",

URDHËROJ:

1. Publikimin në faqen zyrtare të institucionit, në rubrikën "Open Data", të listës së dokumenteve ekzistuese që ofrohen në formatin e të dhënave të hapura për qëllime ripërdorimi.
2. Kjo listë të përditësohet periodikisht me dokumente, që prodhohen nga strukturat përbërëse të institucionit, për qëllime ripërdorimi.
3. Ngarkohet z. Pëllumb Feneri dhe z. Hekuran Resuli për zbatimin e këtij urdhëri.
4. Ndjek zbatimin e këtij urdhëri Sekretari i Përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PREFEKTI

Arben Cuko

